



Rr. "Komuna e Parisit" Nr. 4

Po. Box. 7435

Tiranë, Shqipëri.

Tel. / fax 00355 / 4/ 321389

[www.misionishenjteroreleonore.org](http://www.misionishenjteroreleonore.org)

e- mail: [misionel@yahoo.com](mailto:misionel@yahoo.com)

Dt. 05/03/2008

Nr. 05 Prot.

## DEKLARATE SHTYPI

Per artikullin e gazetes Koha Jone mbi "denoncimin" kunder Misionit Shenjteror Eleonore, dt. 3 Mars 2008.

Deklaroj se si Kryetare e Fondacionit nuk me eshte kerkuar asnje prononcim nga gazeta "Koha Jone". Mungesa e tentatives per te kontaktuar personin tim ngre disa pikepyetje mbi paanshmerine e kesaj gazete. Publikimi i adreses elektronike zyrtare te Misionit si dhe times personale hedhin poshte pretendimin se kane munguar mundesite e kontaktit. Punonjesit e Institucionit te Misionit Shenjteror Eleonore deklarojne se askush nga gazeta "Koha Jone" nuk ka shkuar te kontaktoje me ta per kete shpifje.

Une dua t'ju terheq vemendjen, duke besuar se nuk eshte ne qellimin tuaj, qe pa dashje po kontribuoni ne qellimin e grupit kriminal i cili deshtoi ne tentativen per vrasje ndaj personit tim. Me lejoni t'ju bej nje pyetje: si mund te beni publik adresen e nje personi qe i rrezikohet jeta? Jo vetem nuk po respektoni etiken tuaj te gazetarit, por, po rivini ne rrezik jeten e personit tim, duke ekspozuar adresen fizike. Ndersa per gjithshka tjeter qe diskutohet, jam gati te sjell qindra, mijera raste ne 20 vjet te punes sime spirituale, ku besimtare dhe jobesimtare jane ndihmuar e orientuar per te permiresuar kualitetin e jetes se tyre. Per kedo qe ka ndjekur deri me tani ngjarjet diskriminuese ndaj Misionit tone si dhe per te gjithë besimtarët e Misionit Shenjteror Eleonore, eshte e qarte se ky "denoncim" eshte skenari i radhes.

Grupi i krimineleve pasi deshtoi ne tentativen per vrasje, ka hartuar nje forme te re dhe kesaj here me te sofistikuuar: kunder doktrines. Doktrina spirituale eshte shkruar ne dy libra dhe eshte e verifikueshme. Dhe kjo doktrine zbriti si rezultat i ekzistences te atij Informacioni qe akuzohet sot. Pse duhet besuar se kjo Doktrine zbriti prej andej? Sepse une isha e diplomuar vetem si teknike tekstili, me pare se une te merrja kete Komunikim